



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Lënda: Përcjellje për kompetencë

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcjellë kërkesa për informacion e z. {...}, regjistruar me numër rendor 38 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4145/2 prot., datë 23.08.2024, në të cilën ka kërkuar vënien në dispozicion të kopjeve të vendimeve gjyqësore, për çështjet në të cilat kanë qenë të përfshirë shtetas të huaj, në veçanti shtetasit gjerman dhe që lidhen me kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Për sa më sipër, në kushtet kur informacioni i kërkuar nuk administrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, por nga vetë gjykatat, bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ju përcjellim për trajtim kërkesën për informacion të z. {...}.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, bashkëlidhur gjeni një kopje të shkresës nr. 4145/2 prot., datë 23.08.2024.